

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR URDHRIN E STOMATOLOGUT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Shërbimi stomatologjik në Republikën e Shqipërisë është një nga shërbimet e para të privatizuara së bashku me shërbimin farmaceutik. Ky shërbim ka njohur ndryshime cilësore përgjatë këtyre 20 viteve. Kjo i dedikohet, në radhë të parë, reformave të ndërmara nga Ministria e Shëndetësisë dhe, së dyti, nismës së vetë profesionistëve. Me të gjitha përmirësimet në këtë shërbim, mbetet ende shumë për t'u bërë në raport me etikën profesionale, kontrollin e standardeve në ushtrimin e profesionit dhe marrëdhëniet stomatolog - pacient.

Me këtë projektligj propozohet krijimi i një urdhri të veçantë për stomatologët, si ent publik jobuxhetor, i cili përfaqëson interesat e përbashkët të profesioneve, stomatologë dhe ndihmësstomatologë, si dhe rregullon marrëdhëniet ndërmjet tyre në funksion të publikut.

Një eksperiencë e tillë u referohet vendeve, si: Republika e Maqedonisë, Republika Çeke, Kroacia, Lituania, Sllovakia, Austria, Belgjika, Gjermania, Franca, Britania e Madhe dhe Irlanda.

Objektivi kryesor i këtij projektligji është rregullimi i marrëdhënieve të kësaj bashkësie jo vetëm kundrejt shtetit, por gjithashtu dhe mbrojtjen e popullatës nga kequshtrimi i profesionit të stomatologut dhe profesioneve të tjera që kanë lidhje me të. Gjithashtu, ky projektligj bën të mundur delegimin e kompetencave për dhënie të së drejtës së ushtrimit të profesionit të stomatologut dhe ndihmësstomatologut nga një trupë profesionistësh me kontribut të theksuar në fushën stomatologjisë dhe përmirësimin e edukimit të vazhduar dhe ngritjen profesionale të stomatologëve.

Projektligji është i përbërë nga katër krerë.

Në kreun e parë parashikohen qëllimi i ligjit, fusha e zbatimit të tij dhe statusi i Urdhrit të Stomatologut.

Në kreun e dytë përcaktohen misioni dhe buxheti i Urdhrit.

Urdhri i Stomatologut do të përbëhet nga stomatologët dhe ndihmësstomatologët, që ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë dhe që përmbushin kushtet për të qenë anëtarë sipas këtij ligji. Projektligji parashikon kriteret e anëtarësimit në Urdhrit të Stomatologut si dhe detyrimet e anëtarëve të Urdhrit.

Urdhri i Stomatologut, gjatë kryerjes së detyrave, duhet të mbajë lidhje të vazhdueshme me Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet e saj të varësisë si dhe me ministrinë, institucionet qendrore dhe organizma të tjerë, të krijuar sipas legjislacionit në fuqi, publikë ose jopublikë.

Një nen i rëndësishëm në projektligj është edhe neni ku trajtohet buxheti i Urdhrit. Si ent publik i pavarur, Urdhri i Stomatologut ka buxhetin e tij, të cilin e miraton Asambleja Kombëtare dhe e administron vetë në përputhje me rregullat financiare në fuqi. Në mënyrë që të mbështetet ngritja e Urdhrit të Stomatologut nga shteti është menduar që të ketë një subvencionim për një periudhë 1-vjeçare, duke filluar në vitin 2016, nga buxheti i parashikuar për Ministrinë e Shëndetësisë.

Në projektligj parashikohet dhe mënyra e drejtimit dhe e organizimit të Urdhrit. Organet drejtuese të Urdhrit do të jenë asambletë, presidentët, këshillat, komisionet disiplinore.

Asambletë janë organizuar në nivel kombëtar dhe rajonal.

Asambleja është organi më i lartë drejtues i Urdhrit dhe do të mbledhet çdo pesë vjet. Asambleja Kombëtare përbëhet nga të gjithë anëtarët e këshillave rajonale dhe zgjedh Këshillin Kombëtar.

Gjithashtu, projektligji trajton edhe Asamblenë Rajonale e cila përbëhet nga 1/5 e përfaqësuesve të anëtarëve të Urdhrit të Stomatologut të rajonit. Kjo asamble zgjedh Këshillin Rajonal, për të cilin bëhen zgjedhje çdo pesë vjet.

Në një nen të veçantë trajtohen edhe mënyra e zgjedhjes së Presidentit të Urdhrit, kriteret që duhet të përmbushin kandidaturat për këtë funksion dhe përfundimi i mandatit të presidentit të Urdhrit.

Një nen i rëndësishëm në projektligj është edhe neni ku trajtohen masat disiplinore të cilat janë pothuajse të unifikuara për të gjithë urdhrat profesionalë në fushën e shëndetësisë.

Konkretisht, në nenin 15 përcaktohet se komisioni disiplinor heton dhe gjykon në bazë të fakteve dhe provave të administruara dhe seancës dëgjimore dhe mund të vendosë masa disiplinore që nga vërejtjet me shkrim, me paralajmërim, gjobë nga 15 000 deri 250 000 lekë, propozim për shkarkim nga funksione drejtuese në institucione shëndetësore, publike dhe private, pezullim nga e drejta e zgjedhjes në organet drejtuese të Urdhrit të Stomatologut, për një periudhë deri në 3 (tre) vjet apo përjashtim nga Urdhri i Stomatologut për një periudhë deri në 3 (tre) vjet.

Miratimi i këtij projektligji është një hap i rëndësishëm që do të ndikojë në përmirësimin e shërbimit stomatologjik si dhe ndërgjegjësimin e profesionistëve në këtë fushë.

KËSHILLI I MINISTRAVE